



Pranuar / Dorezuar Priljenoi/Prodato Received/Delivery	14.06.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot No Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicitina Quantity
SKPMSHCK	3060/2021		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.352/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 30.04.2021 me numër A.nr.352/2021, e parashtruar përmes formës elektronike në E-mail zyrtar në adresën [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), nga ankuesi me adresë zyrtare [isa.elshani@rks-gov.net](mailto:isa.elshani@rks-gov.net), kundër Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë/Agjencia e Metrologjisë së Kosovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.06.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**I.REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.352/2021 e datës 30.04.2021 e parashtruar nga ankuesi.

**II.MBETET** në fuqi Akte emërimi i datës 09.07.2012 i ankuesit Isa Elshani, në pozitë : Udhëheqës i Divizionit të Metrologjisë “.

**III. ANULOHET** Vendimi numër protokolli 02/1023 i datës 01.10.2013 i nxjerrë nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë/Agjencia e Metrologjisë së Kosovës, në pozitë “ Udhëheqës i Divizionit të Metrologjisë “, në Departamentin e Metrologjisë, sipas Akte emërimit të datës 09.07.2012, me datë 01.10.2013 Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 02/1023, me të cilin ankuesin e ka avancuar me gjysmë koeficienti nëntë

pikë pesë (9.5), në kuadër të kategorisë funksionale në pozitë: " Udhëheqës i Drejtoratit të Metrologjisë Ligjore", në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës.

Ankuesi i pa kënaqur me mos zbatimin e këtij vendimi, me datë 17.03.2021 për mes E-mailit zyrtar, e ka njoftuar Sekretaren e Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për zbatim të Vendimit të datës 01.10.2013, për harmonizim të koeficientit të pagës, si dhe që ti lëshohet Akte emërim i ri, duke kërkuar kompensimin e pagave retroaktive nga data 01.01.2014, nga momenti që ushtron pozitën " Udhëheqës i Drejtoratit të Metrologjisë Ligjore", në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, sipas këtij vendimi.

Kundër mos pranimit të përgjigjes nga ana e Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ankuesi me datë 30.04.2021 ka parashtruar ankesë përmes formës elektronike në E-mail zyrtar në adresën [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datës 30.04.2021 me numër protokollit 2145/21, me pretendime ankimore për zbatimin e Vendimit të datës 01.10.2013 që ti bëhet harmonizimi i koeficientit të pagës, ti lëshohet Akte emërim i ri, duke pretenduar kompensimin e pagave retroaktive nga data 01.01.2014, nga momenti që ushtron pozitën "Udhëheqës i Drejtoratit të Metrologjisë Ligjore", në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.05.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë 27.05.2021 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit të datës 30.04.2021 me numër A.nr.352/2021, e parashtruar përmes formës elektronike në E-mail zyrtar në adresën [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), nga ankuesi Isa Elshani, me adresë zyrtare elektronike [isa.elshani@rks-gov.net](mailto:isa.elshani@rks-gov.net); Vendimi me numër protokollit 02/1023 të datës 01.10.2013 të nxjerrë nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Email i datës 17.03.2021; Akte emërimi i datës 09.07.2012; Përshkrim i detyrave të punës i datës 02.04.2012; Lista e pagave nga data 01.03.2021 deri me datë 31.03.2021; Përgjigje në ankesë e datës 27.05.2021; Kërkesë për avancim të zyrtarit e datës 30.09.2013 nr. protokollit 13/1014; Pëlqimi i datës 30.09.2013 nga

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, fillimisht ka analizuar shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se ankuesi me datë 17.03.2021 për mes E-mailit zyrtar, ka njoftuar Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me pretendimin që ti bëhet zbatimi i Vendimit të datës 01.10.2013, për harmonizim të koeficientit të pagës me koeficientin 9.5, si dhe që ti lëshohet Akte emërim i ri, duke pretenduar se nga data 22.12.2020 e ka njoftuar sekretaren lidhur me këtë çështje që ti bëhet kompensimi i pagave retroaktive nga data 01.01.2014, kundër mos pranimit të përgjigjes nga ana e Sekretares së

Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ankuesi me datë 30.04.2021 ka parashtruar ankesë përmes formës elektronike në E-mail zyrtar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi pasi që ka pranuar Vendimin me numër protokoll 02/1023 të datës 01.10.2013 të nxjerrë nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me të cilin ankuesi është avancuar për gjysmë koeficient, nëntë pikë pesë (9.5), duke cekur në pikën I në kuadër të kategorisë funksionale në pozitë: "Udhëheqës i Drejtoratit të Metrologjisë Ligjore", në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, kurse në pikën II të vendimit është theksuar citoj; " në mungesë të buxhetit për vitin 2013 ,nëpunësi pajtohet me koeficientin nëntë(9) deri në fund të vitit 2013, ", ....kurse pika III citoj: " i përmenduri punët dhe detyrat e punës së Udhëheqës i Drejtoratit të Metrologjisë Ligjore do të filloj ti kryej nga data 01.10.2013", ka qenë i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga data e mos zbatimit të këtij vendimi, që llogaritet data 01.02.2014, momenti që e ka kuptuar ankuesi se nuk i është bërë pagesa në llogarinë e bankës, të parashtror ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në pajtim me ligjin në fuqi në atë periudhë të përcaktuar në dispozitat ligjore përkatësisht nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, të Ligjit nr.03/L-192 mbi Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: " që para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati, i cili pretendon se është dëmtuar duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave të organit përkatës të punësimit...."i cili ligj ka qenë në fuqi deri me datë 09.09.2018, pasi që me datë 10.09.2018 ka hy në fuqi Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe duke vepruar në kundërshtim me procedurën e parashtrimit të ankesës të përcaktuar në nenin 3 paragrafin 5 të Rregullores Nr.03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku thuhet: "Para parashtrimit të ankesës në Këshill, ankuesi duhet t'i ketë shteruar, procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën në afatin prej 30 ditësh, ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm", po ashtu duke u ndërlidhur me nenin 82 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: " 1. Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. 2. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se në rastin konkret ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës me datë 30.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka tejkalluar afatet ligjore që lidhen me veprimet e tij administrative, i cili me rastin e adresimit të ankesës në këshill ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", poashtu kolegji konstaton se ankesa është parashtruar edhe jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore edhe sa i përket heshtjes administrative të përcaktuar në nenin 127

paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcakton se: *"4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se, me datë 25.06.2010, ka hy në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka përcaktuar që nëpunësve civil t'ju shndërrohen kontratat e punës në akt emërimi dhe ankuesi sipas Akte emërimit të datës 09.07.2012, ka themeluar marrëdhënie të punës në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë, në pozitë: "Udhëheqës i Divizionit të Metrologjisë", në Departamentin e Metrologjisë, në pajtim me këtë ligj, kurse me datë 01.10.2013 Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 02/1023, me të cilin ankuesin e ka avancuar me gjysmë koeficienti nga koeficienti nëntë (9) në koeficientin nëntë pikë pesë (9.5), në pozitë: "Udhëheqës i Drejtoratit të Metrologjisë Ligjore", në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, duke theksuar se bëhet fjalë për kategori funksionale të njëjtë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 27 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: *"1. Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimi të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale"*, që në rastin konkret Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka tejkalluar kompetencat e saja me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi, duke rënë ndesh me dispozitën ligjore të lartë cekur dhe ligjin në fuqi në periudhën e nxjerrjes së këtij aktit juridik.

Andaj, mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi numër protokollit 02/1023 i datës 01.10.2013 i nxjerrë nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është akt i pa ligjshëm i nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që përcakton se; *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"*, dhe ky vendim si i tillë nuk prodhon efekt juridik, po ashtu dhe pretendimi i ankuesit që ti lëshohet Akte emërimi i ri, është i pa bazuar në ligj.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hy në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda ,A.nr.352/2021, datë 14.06.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë,
- Udheheqesit të Personelit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

